

Titulli i temës së diplomës Master:	Aspektet kushtetuese dhe ligjore të Dhomave të Specializuara të Kosovës
Kandidati:	Valon Alija
Mentori:	Prof. Dr. Arsim Bajrami

ABSTRAKT

Kuvendi i Republikës së Kosovës (në vitin 2015) ka amendamentuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës duke i paraprirë miratimit të Ligjit për “*Dhomat e Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar*”. Duke pasur parasysh specifikat juridike në të cilat është themeluar por edhe sfidat më të cilat është ballafaquar që në fillim të funksionimit të saj, Dhomat e Specializuara paraqesin një rast me interes për studim.

Përmes këtij studimi synohet që të jepet kontribut në fushën Kushtetuese, në çështjet e ndërlidhura me themelimin dhe funksionimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës duke mbajtur në fokus aspektet kushtetuese, specifikat e konstatuara në funksionimin adekuat të Dhomave të Specializuara sipas qëllimit të themelimit të tyre si dhe ndikimin në mjedisin politik dhe ligjor në Kosovë dhe për Kosovën.

Në proces të realizimit të këtij punimi janë shqyrtuar burime primare dhe sekondare të dhënave në dispozicion, legjislacioni përkatës në Republikën e Kosovës si dhe Raportet e ndryshme të organizatave ndërkombëtare por edhe organizatave joqeveritare. Me qëllim të trajtimit adekuat të temës së propozuar, janë aplikuar metodat e përshtatshme si: metoda juridike, metoda analitike, metoda krahasuese dhe historike.

Nga shqyrtimi i kësaj tematike, konstatohet se procesi i zhvillimit dhe reformimit të sistemit të drejtësisë në Kosovë ka qenë më i ndërlikuar dhe i vështirësuar nga rrethanat specifike në Kosovë. Një nga sfidat më të cilat është përballe sistemi juridik në Kosovë është edhe ajo që ndërlidhet me themelimin e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

Edhe pse dihet se gjykatat ndërkombëtare/të ndërkombëtarizuara janë themeluar dhe kanë funksionuar edhe në të kaluarën e në vende tjera, Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar ka specifikat e veta meqë është themeluar nga Kosova, bazohet në ligje të Kosovës por me gjykatës e prokurorë nga jashtë Kosova. Këto dhe veçori të tjera bëjnë që Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të konsiderohen si një kapitull i veçantë në të drejtën ndërkombëtare penale dhe në procedurë penale ndërkombëtare.

Edhe pse të themeluara në kontekst të përpjekjeve për të adresuar nevojën e ndërprerjes së pandëshkueshmerisë dhe përkushtimit për rrugën integruese të Kosovës, themelimi dhe funksionimi është përcjellë me shqetësime të ndryshme dhe debate intensive kryesisht për çështjet që kanë të bëjnë me shqetësimet rreth targetimit të vetëm një grupi etnik dhe koncentrimin e madh të autoritetit.

Prishtinë, 2022